



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



KËSHILLI I QARKUT SHKODËR

Nr. 602/p prot.

Shkodër më 25 09 2025

V E N D I M

Nr. 18, datë 24.09.2025

PËR

“AKORDIMIN E TITULLIT VENDOR ‘NDERI I QARKUT SHKODËR’ TRUPËS MUZIKORE “THE DOOR ALBANIA”

Këshilli i Qarkut Shkodër, në mbledhjen e datës 24.09.2025, mbështetur në nenin 77 pika II) dhe 78 pika të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, në nenin 10 dhe vijues të ligjit 94/2022 “Për titujt e nderit dhe titujt vendore të nderit në Republikën e Shqipërisë”, pasi shqyrtoi **propozimin e Kryetarit të Këshillit të Qarkut Shkodër** dhe kërkesat e paraqitura nga shkolla Speciale “3 Dhjetori”- Shkodër dhe Qendra Kulturore e Fëmijëve “Kujtim Alija” Shkodër, me prezencën e 16 anëtarëve të tij, me 16 vota Pro dhe asnjë kundër,

V E N D O S I:

1. T’i akordohet trupës muzikore “The Door Albania” titulli vendor “Nderi i Qarkut Shkodër”, me motivacion: *“Për kontributin e vyer artistik dhe shoqëror të këtij grupi muzikor që ka promovuar për 20 vite me radhë barazinë, dinjitetin njerëzor dhe fuqinë e artit, si mjet për përfshirje, solidarizim dhe frymëzim në komunitetin e qarkut tonë, në mbarë vendin dhe jashtë tij.”*
2. Ngarkohet Kryetari i Këshillit të Qarkut Shkodër për zbatimin e këtij vendimi dhe organizimin e ceremonisë së akordimit.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit në Këshillin e Qarkut Shkodër sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, (i ndryshuar)

